

Hapet Thirrja për Bursa në Programin Erasmus + në Universitetin Eberswalde, Gjermani

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Eberswalde, në kuadër të programit Erasmus + të Komisionit Europian, për stafin akademik të UT-ës.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

Fushat e shkëmbimit për stafin akademik:

- Global Change Management;
- International Forest Ecosystem Management;

Kohëzgjatja e bursave:

- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie (7 ditë);

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (140 EUR në ditë për stafin)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze në nivelin B2;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

**Mobility Plan është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen gjatë periudhës së mobilitetit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus + Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

Afati për aplikim: 12 Maj 2017

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al me subjekt, emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe universitetin në të cilin po aplikon.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!